



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacije
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade, and Innovation

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018, Vendimin nr. 5235 datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 datë 09.06.2023 me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë, dhe Inovacionit përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për përkrahjen financiare të NMVM-ve në sektorin e Industrisë Kreative (IK)

MINTI/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme. Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jenë qytetar të Republikës së Kosovës.

Shuma totale e skemës së grantit është 450,000.00 €.

Granti do të ndahet në tri kategori, si vijon:

Kategoria 1 – Ndërmarrjet mikro (të punësuar deri në 9 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve mikro është 200,000.00 €

Kategoria 2 – Ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri në 49 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të vogla është 150,000.00 €

Kategoria 3 – Ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri në 249 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të mesme është 100,000.00€.

Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINTI/KIESA) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINTI/KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikuesit të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/> ndërsa, për të aplikuar në këtë grant skemë, dokumentet e kërkuara sipas udhëzuesit duhet të dërgohen në këtë email adresë: aplikimi.ikreative@rks-gov.net

Thirrja për aplikim është e hapur nga data 23.03.2026 deri më datë 15.04.2026.